Kjo kontratë është specifike dhe duhet të trajtohet njëjtë nga të gjitha palet dhe nuk mund të përdoret kontrata specifike për projekte të përgjithshme pa qenë specifikuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -5 **Përgjigje nga Eksperti profesional**

Kamion për transport betoni (auto betonierke-mixer) (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar deshmi si në vijim:

- **Kamion me targa AA 247 ZV**
- **Kamion me targa AB 453 CJ**
- **Kamion me targa AB 928 CO**
- **Kamion me targa AA 921 CO**

Keta kamiona janë në pronesi të kompanisë ALESIO 2014 SHPK, mirepo për keta kamiona nuk ka asnjë marrëveshje ndërmjet PEVLAKU SHPK me Alesio 2014 SHPK se i ka marrë me qira keto pajisje lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

Nëse grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar një kontratë qiraje të lidhur ndërmjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhënës dhe PEVLAKU SHPK si qiramarrës për projektin "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - pjesë e qarkorës së qytetit" në Gjakovë, kjo është një kontratë që nuk i përket aktivitetit të prokurimit: **"Ndërtimi i Rrugës X"** me nr. të prokurimit: **"632-23-397-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS** dhe si e tillë është e pavlefshme.

Kur një kompani ka nevojë për pajisje me qera për të zhvilluar një projekt specifik, është e rëndësishme të ketë një kontratë të lidhur për qira të këtyre pajisjeve për projektin perkates. Në këtë rast, pasi kontrata e qirajit është e lidhur për projektin e caktuar **"Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - pjesë e qarkores së qytetit"**, ajo nuk ka validitet për të vlerësuar si kontratë e lidhur ndermejt dy paleve për projektin në fjale.

Ne dosje të tenderit nuk është kjo kontratë por pas kërkesës për informata shtese nga AK drejtuar OE të rekomanduar për kontratë është dërguar kjo marrëveshje e cila nuk i plotëson kërkesat e një kontrate për aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Rrugës X"** me nr. të prokurimit: **"632-23-397-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MIHAL DURI
TEL: 0682033057

KONTRATË QIRAJE

(PASURI TË LUAJTSHME)

Nr. repertori: 2890

Nr. koleksioni: 1214

Tiranë më 18/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7559, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9387, datë 10.03.2008 "Për subnjtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

¹ Ky dokument përbëhet nga 2 fletë



A2023053630136059117



KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë 10.05.2023, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI, u paraqit personalisht

QIRADHËRËSI: Shoqëria **ALESIO – 2014 shpk**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L41713003M, me seli në adresë Njësia Bashkiake Nr. 11, Rruga Lord Bajron, Banese Private Nr. 14, përfaqësuar nga Administratori Agjan Baci, atësia Iljas, amësia Bylyre, shtetas Shqiptar, lindur në Sanjollas, Kolonjë dhe banues në TIRANË, me adresë Odhise Grillo; Nd. 41/1; H. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 28/04/1974, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjofllim ID nr. 034079673 dhe nr. personal H40428036C.

QIRAMARRËSI: Shoqëria **"PE-VLA-KU"** sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit K61716013M, me selinë Tirane, me adresë Rruga "Muzaket", Pallatet Vokshi, Kati i 7, Apartamenti 42, Tirane, përfaqësuar nga Administratori Z. Vladimir Pjetergjokaj, atësia Ndue, amësia Sofi, shtetas Shqiptar, lindur në Jaho Salihi dhe banues në Tiranë, lindur më 16.05.1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjofllim ID nr. 033265951 dhe nr. personal H20516169B, në vijim e quajtur Qiramarrësi.

BAZA LIGJORE: Neni 801 e vijues të Kodit Civil Neni 62, pika 1, gërma "lf", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 *"Për Notarinë"*.

Palët e mësipërme, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ranë dakord të lidhin këtë kontratë qiraje me kushtet e mëposhtme:

Duke qenë se:

- Shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k. marr pjesë në tenderin *"Ndërtimi i rruges dalja per Peje - Pjese e qarkores se qytetit"* me Autoritet Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo është e interesuar të marrë me qera mjetet e nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Përshkrimi	Te Dhenat
Eskavator me peshe min 10 ton	Kontrate shit blerje nr. Rep. 1491 nr. Kol 661 Date 21/06/2016
Eskavator me rrota gome	Targa : AJMT65 Leje qarkullimi : TRDA3665020 Shasia : PW1506KK34144
Kamionete dubelkatine	Targa : AA083VA Leje qarkullimi : TRDA3992618 Shasia : ZCFC3591005478242



Fq. 1



A203305363013025917

Kamionete dubelkabine	Targa : AB230AG Leje qarkullimi : TRDA1718820 Shasia : WF0EXXTTGEG023928
Autopompe betoni	Targa : AA803TH Leje qarkullimi : TRDA0729918 Shasia : ZCNH884456P513412
Autopompe betoni	Targa : AA237YK Leje qarkullimi : TRDA3613119
Autobetoniere	Targa : AA247ZV Leje qarkullimi : SHD0042120 Shasia : ZCNH884448P515573
Autobetoniere	Targa : AB453CJ Leje qarkullimi : TRD00202021 Shasia : WJMJ4CTS40C173946
Autobetoniere	Targa : AB928CO Leje qarkullimi : TRF01930021 Shasia : WJMJ4CUS70C422319
Autobetoniere	Targa : AA921CO Leje qarkullimi : TRDA4708917 Shasia : WJMJ4CSS00C121976
Makina (Finisher) me rrota per asfaltimin e rugeve	Fature tatimore nr. 581 Date : 20/07/2015
Makina mini (Finisher) per asfaltim	Deklarate doganore nr. 85652 Date : 11/09/2018
Cilinder me rrota hekuri me vibrim min 8 ton	Fature tatimore nr. 82 Date : 16/08/2019
Kamion sperkatese per bitumen dhe emulzion ne ruge	Targa : AA704PY Leje qarkullimi : TRDA1045717 Shasia : YB1E5A2A1NB490531


b) Shoqëria **"ALESIO - 2014 "sh.p.k.**, disponon dhe ka në pronësi mjetet qe i nevojiten Qeramarrësit Shoqëria **"PE-VLA-KU"** sh.p.k si dhe është e interesuar per dhenien me qera te tyre,

palet bien dakord dhe nënshkruajnë si vijon:

- Qiradhënësi i jep në përdorim me qira shoqërisë **"PE-VLA-KU"** sh.p.k (Qiramarrësit), makinerite e kerkuara, në rast se ajo fiton tenderin në fjalë.
- Qiradhënësi dorëzon keto mjete tek Qiramarrësit ne gjendje te mire pune, menjehere sapo ky i fundit lidh kontraten, pas fitimit te tenderit.
- Mjetet janë të pajisura me dokumente te vlefshme sipas ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi si dhe jane konform kërkesave te tenderi te paraqitura ne paragrafin "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit"



Fq. 2


A2023055650136059117

d) Afati i dhënies me qera të këtyre mjeteve, përfshin të gjithë kohën e nevojshme që do duhet për të realizuar projektin sipas kontratës dhe grafikut të punimeve, në rast se tenderi fitohet nga pala Qiramarrëse, si dhe Qiradhënesi deklarohet qartësisht se nuk do të leshojë keto mjete me qira asnjë subjekti tjetër, gjatë gjithë kësaj periudhe.

e) Pagesa do t'i bëhet Qiradhënësit nga ana e Qiramarrësit sipas situacioneve dhe faturave përkatëse mujore, në datën 10 të çdo muaji.


f) Është në ngarkim të Qiramarrësit furnizimi me karburant dhe lubrifikant i mjeteve gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre, si dhe kryerja e të gjithë shërbimeve të zakonshme të nevojshme për mbarëvajtjen e mjeteve.

g) Defektet e mundshme të mjeteve mbulohen nga Qiradhënësi gjatë gjithë periudhës së kontratës.


Për-çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, në rast të kundërt kalon për zgjidhje pranë gjykatës kompetente.



Kjo kontratë ju lexua palëve prej meje, noterit, me zë të lartë dhe të qartë, ato më deklaruan se e dëgjuan, e kuptojnë, gjejnë të shprehur në të vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e pranojnë dhe e nënshkruajnë para meje dhe unë noterit e vërtetoj përmbajtjen e kësaj kontrate dhe nënshkrimin e tyre në bazë të ligjit.


Shoqëria "ALESIO - 2014" shpk
Administrator Arjan Baci



Shoqëria "PE - VLA - KU" shpk
Përf. nga Vladimir Pjetërgjokaj





NOTER
GJERGJ KONGOLI


NOTER
GJERGJ KONGOLI

Fq. 3

Pretendimi juaj ankimor **është i bazuar** në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar , pra kontrate e prezentuar nga OE te rekomanduar per kontrate pas kerkeses per informacione shtese eshte derguar kjo marreveshje e cila nuk i ploteson kerkesat e nje kontrate per aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i Rruges X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS

PRETENDIMI ANKIMOR - 6

5.Tek lista e pajisjeve ne dosje te tenderit tek numri rendor 23 eshte kerkuar: Kamion sperkates per bitum dhe emulsion-1.

Me sqarim shtese ne lidhje me kete pajisje, grupi i OE te rekomanduar per kontrate eshte pergjigjur si ne vijim:

Per piken 23, Kamion sperkatese per bitum dhe emuluzion

Edhe kjo makineri eshte makineri e mare me kontrate qeraje nga Shqiperija, nga kompania "Alesio -2014" shpk e cila gjendet ne pjesen e 29 to dosjes se tenderit, tek faqja 202, ndersa dokumenti i mjetit ne fjale eshte ne faqen 268, ku eshte e paraqitura fatura e blerjes nr.18 me te dhenat dhe dokumentet tjera te mjetit,

Nga analizimi i dokumentacionit te ketij grupi te OE te rekomanduar per kontrate dhe nga sqarimi i dhene ne lidhje me kete pajisje, ju sqarojme si ne vijim:

Ne pjesen nr.29 te dosjes se tenderit te dorezuar nga grupi i OE te rekomanduar per kontrate eshte nje kontrate qiraje ndermjet Qiradhenesit ALESIO 2014 SHPK dhe qiramarresit PEVLAKU SHPK, ku pajisjet te cilat merren dhe jepen me qira ne kete marreveshje jane ne listuara si ne vijim:

Duke qene se;

a) Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjesë në tenderin "Ndërtimi i Rrugës X" me Autoritet Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo është e interesuar të marrë me qera mjete të nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Përshkrimi	Te Dhenat
Kamionete dubelkabine	Targa : AA083VA Leje qarkullimi : TRDA3992618 Shasia : ZCFC3591005478242
Kamionete dubelkabine	Targa : AB230AG Leje qarkullimi : TRDA1718820 Shasia : WF0EXXTTGEG023928
Autopompe betoni	Targa : AA803TH Leje qarkullimi : TRDA0729918 Shasia : ZCNH884456P313412



Fq. 1

Nga kjo liste shihet qarte se **NUK** ka dhenie/marrje me qira per pajisjen **Kamion sperkatese per bitum dhe emulsion**. Pra kjo pajisje nuk eshte pjese e kontrates ne fjale.

Sa i perket pergjigjes me sqarime, ku eshte cekur fatura e blerjes me Nr.18 na faqen 268, ju sqarojme se ne kete fature figuron se e ne kete fature figuron se e ka blere ALESIO 2014 SHPK nje kamion te perdorur me cisterne bitumi, mirepo kjo fature nuk ka te beje fare me kontraten per qira te pajisjeve dhe kjo pajisje e cekur ne fature nuk eshte pjese e kontrates, te

ciles i eshte referuar edhe vete grupi i OE to rekomanduar per kontrate.

Thjesht kjo fature eshte nje dokument i parendesishem dhe i pavlere per kete projekt sepse nuk eshte i perfshire ne kontrate per qira per pajisje. Per me teper fatura eshte goxha e padukshme dhe e paqarte.

Me sqarime shtese grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka ofruar edhe nje kontrate qiraje te lidhur ndermjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhenes dhe PEVLAKU SHPK si qiramarres, e ku ne listen e kesaj kontrate gjendet Kamion sperkates per bitum Targa AA 704 PY.

Kamion sperkatese per bitumen dhe emulzion ne rruge	Targa : AA704PY Leje qarkullimi : TRDA10457 Shasia : YB1E5A2A1NB49
---	--

Me kete ngjyre e ka hijezuar vete grupi i OE te rekomanduar per kontrate duke aluduar se kjo pajisje eshte marr me gira, mirepo ju sqarojme se kjo pajisje eshte pjese e kontrates se qirase td dt.18.05.2023, e qe kjo kontrate nuk ka te beje me projektin qe ka ofertuar ky grup dhe per te cilin i ka dhene sqarimet, por kjo kontrate eshte per nje projekt tjeter, e ku ne kete kontrate shkruan qarte si ne vijim:

Duke qene se:

Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjese ne tenderin "Ndertimi i rruges dalja per Peje-Pjese e qarkores se gytetit" me Autoritetin Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo eshte e interesuar te marre me qera mjetet e nevojshme per kryerjen e punimeve , ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Pra eshte fjale per projektin "Ndertimi i rruges dalja per peje-pjese e qarkores se gytetit"- KK Gjakove.

Thjesht kjo kontrate per qira eshte e pavlefshme dhe nuk mund te merret parasysh sepse eshte e lidhur per nje projekt tjeter. **Kjo kontrate nuk ka vlere per asnje nga pajisjet qe jane te cekuar ne late kontrate sepse nuk ka te beje me ate projekt dhe nuk konsiderohet e vlefshme.**

Sa per krahasim, ju sqarojme se nje kontrate tjeter e lidhur po nga keto dy pale, dhe e dorezuar me dosje te tenderit shkruan qarte dhe specifikohet se eshte per kete projekt e qe gjendet ne faqe 202 ne pjesen 29 te dosjes se dorezuar dhe shkruan si ne vijim:

Duke qene se ;

Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjese ne tenderin "Ndertimi i rruges X" me Autoritetin Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo eshte e interesuar te marre me qera mjetet e nevojshme per kryerjen e punimeve , ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Nga keto sqarime, kuptohet qarte se grupi i OE to rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi per pajisjen Kamion sperkates per bitum dhe emulsion.

Nga deshmite që u ceken me lartë kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar kontratë që nuk janë lidhur për këtë projekt dhe që nuk kanë asnjë vlerë për këtë projekt, mirëpo ka edhe kontratë që është e lidhur për këtë projekt, prandaj nga ky krahasim kuptohen deshmite dhe kontratë që nuk janë për këtë projekt.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -6Pergjigje nga Eksperti profesional

Pretendimi ankimor lidhet me pretendimin nr: 5 ndaj është bashkëngjitur kontratë e cila ka të bëjë me një projekt tjetër por nuk lidhet me **aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS** por bëhet fjale për një projekt tjetër si **"Ndërtimi i rrugës dalja për pejë-pjëse e qarkores së gytetit"-KK Gjakovë**.

Duke qenë se:

- a) Shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k. mori pjesë në tenderin "Ndërtimi i rruges dalja per Peje - Pjese e qarkores se qytetit" me Autoritet Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo është e interesuar të marrë ose qera mjeteve e nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Përshkrimi	Te Dhenat
Eskavator me peshe min 10 ton	Kontrate shit blerje nr. Rep. 1491 nr. Kol 661 Date 21/06/2016 Targa : AJMT65
Eskavator me rrota gome	Leje qarkullimi : TRDA3665020 Shasia : PW1506KK34144 Targa : AA083VA
Kamionete dubellabine	Leje qarkullimi : TRDA3992618 Shasia : ZCFC3591005478242



Fig. 1

Kamionete dubellabine	Targa : AB230AG Leje qarkullimi : TRDA1718820 Shasia : WF0EXXTTGEG023928
Autopompe betoni	Targa : AA803TH Leje qarkullimi : TRDA0729918 Shasia : ZCNH884456P513412
Autopompa betoni	Targa : AA237YK Leje qarkullimi : TRDA3613119
Autobetoniere	Targa : AA247ZV Leje qarkullimi : SHD0042120 Shasia : ZCNH884448P515573
Autobetoniere	Targa : AB453CJ Leje qarkullimi : TRD00202021 Shasia : WJM4CTS46C173946
Autobetoniere	Targa : AB928CO Leje qarkullimi : TRF01930021 Shasia : WJM4CUS70C422319
Autobetoniere	Targa : AA921CO Leje qarkullimi : TRDA4708917 Shasia : WJM4CSS00C121976
Makina (Finisher) me rota per asfaltimin e rrugeve	Future tatimore nr. 581 Date : 20/07/2015
Makina mini (Finisher) per asfaltim	Deklarate doganore nr. 85652 Date : 11/09/2018
Cilinder me rota hekuri me vlerim min 8 ton	Future tatimore nr. 82 Date : 16/08/2019
Kamion spekaliese per blumen dhe smulzion na rruge	Targa : AA704PY Leje qarkullimi : TRDA1045717 Shasia : YBHE5A2A1NB490531

- b) Shoqëria "ALESIO - 2014" sh.p.k. disponon dhe ka në pronësi mjeteve qe i nevojiten Qeramarresit Shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k si dhe është e interesuar per dhenien me qera te tyre,

palet bien dakord dhe nëshkruajne si vijon:

- a) Qiradhenesi i jep në përdorim me qira shoqërisë "PE-VLA-KU" sh.p.k (Qiramarresit), makinerite e kerkoara, në rast se ajo fiton tenderin në fjalë.
b) Qiradhenesi dorëzon keto mjete tek Qiramarresit në gjendje te mire pune, menjehere sapo ky i fundit lidh kontraten, pas fitimit te tenderit.
c) Mjetet jane të pajisur me dokumente te vlefshme sipas ligjeve dhe rregullorese ne faqi si dhe jane konform kerkesave te tenderit te paraqitura ne paragrafin "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit"



Pretendimi juaj ankimor është i bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar, pra kontrate e prezentuar nga OE te rekomanduar për kontrate pas kërkeses për informacione shtese është dërguar kjo marrëveshje e cila nuk i plotëson kërkesat e një kontrate për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit: “632-23-397-5-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS por bëhet fjalë për një projekt tjetër si “Ndërtimi i rrugës dalja për pejë-pjëse e qarkores së gytetit”-KK Gjakove.

PRETENDIMI ANKIMOR - 7

6.Tek lista e paisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 23 është kërkuar Buldozher min 25t, ndërsa grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi për këtë pajisje.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -7Përgjigje nga Eksperti teknik

Konstatohet se, te lista e pajisjeve në dosjen e tenderit nr.rendor 23 nuk është kërkuar Buldozher min 25 [t], por kjo makinë është kërkuar në dosjen e tenderit nr.rendor 1, dhe të cilën GOE fitues e ka ofruar, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR - 8

7.Ne nenin 9.1&9.2 të DT-së është kërkuar "Operatori Ekonomik duhet të ketë Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit të cilësisë, ndërsa grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi se ka në kuader të grupit Lead Auditor sipas ISO 9001:2015, por ka ofruar dëshmi për auditor të brendshëm. Si auditor të brendshëm ka ofruar dëshmi për z. Redi Binaj.

Për dëshmi të ofruar nga grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk është sipas kërkeses së FDT-së, prandaj edhe për këtë arsye është dashur të eliminohet grupi i OE PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NE KOSOVE; JOOS & KRASNIQI BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.1., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtinë.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -8Përgjigje nga Eksperti profesional

Lead Auditor sipas standardit ISO 9001:2015 është një person i cili ka kualifikime dhe aftësi të nevojshme për të kryer auditime të sistemit të menaxhimit të cilësisë të bazuar në këtë standard. ISO 9001 është një standard ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë, i cili përcakton kërkesat për një sistem efikas të menaxhimit të cilësisë.

Roli i një Lead Auditor është të kryejë auditime të jashtme ose të brendshme të sistemit të menaxhimit të cilësisë në organizata, për të verifikuar nëse organizata po përmbush kërkesat e standardit ISO 9001 dhe ajo po operon në mënyrë të përshtatshme me politikat dhe procedurat e veta të cilësisë.

Një Lead Auditor i kualifikuar do të ketë njohuri të thella për standardin ISO 9001:2015, si dhe për proceset dhe metodologjitë e auditimit. Ai do të jetë në gjendje të planifikojnë, kryejnë dhe dokumentojnë auditimet në një mënyrë objektive dhe të drejtë. Rezultatet e auditimeve të udhëhequra nga një Lead Auditor ndihmonë organizaten të identifikojnë zonat e forta dhe të dobëta të sistemit të tyre të menaxhimit të cilësisë dhe të marrin hapa për të përmirësuar proceset dhe performancën e tyre nëpërmjet rekomandimeve dhe korrektueseve të nevojshme.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar një dokument per **Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit te cilesise** që dëshmon duke e caktuar auditorin e brendshëm prandaj kjo përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe kërkesat e specifikuara nga FDT-ja, .

CERTIFIKATË TRAJNIMI			
Nr. i Certifikatës	AQS/T/5112832023		
Emri Mbiemri	Ing. REDI BINAJ		
Datelindja	20-06-1992		
Arsimimi	INXHINIERI NDERTIMI-INFRASTRUKTURE TRANSPORTI DIP. Nr. M-785 DATE 18-11-2015		
Mori pjese ne trajnimin me teme:			
"SPECIALIST PER ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMIN E KANTIEREVE TE NDERT			
Temat e trajtuara:			
<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr.8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" ndryshuar n Nr.10324, datë 23.9.2010; - Plani i sigurisë për menaxhimin dhe organizimin e kantierit; - Dokumentacioni teknik dhe ligjor që plotësohet në kantier për sigurimin teknik të punonjësve. "Libri i sigurimit teknik"; "Libri i aksidenteve"; - Metodologjite per identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rrezikut; - Masat suplementare në zbatimin e punimeve për punimet e vlerësuara me rrisht të lartë, të mesëm ulët në planin operativ të sigurisë; - Harmonizimi i skemës së sigurisë dhe mbrojtjes në punë të shoqërive zbatuese të punimeve të nd me kërkesat e Standartit ISO 45001:2018 ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr 10324, datë 23.9.201 - Përshtatja e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi për kryerjen e punimeve ndërtimore në kanti synim rritjen e sigurisë në punë; - Hartimi i Planit Operativ të Sigurisë POS, për vlerësimin e rrezikut të cilit i ekspozohen punonjësit g punës në kantier; - Hartimi i dokumentacionit te vlerësimit te riskut ne kompani; - Direktiva Evropiane 89/391 / CEE "Për Shëndetin dhe Sigurinë në Vendin e Punës"; - Raste praktike. 			
Datat e trajnimit	25/04/2023	29/04/2023	Ore 40
Vendi i trajnimit	Tirane, Shkollor		



Pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar sa i përket kërkeses "Operatori Ekonomik duhet të ketë Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit të cilesisë aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS .

PRETENDIMI ANKIMOR - 9

8.Ne nenin 9.1&9.2 te DT-se eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet te ketë nje Lead auditor udheheqes sipas kërkeses se ISO 45001-2018 Sistemi i Menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërsa grupi i OE te rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi se ka ne kuader te grupit Lead Auditor sipas **ISO 45001-2018**, por ka ofruar deshmi per auditor te brendshem. Si auditor te brendshem ka ofruar deshmi per z. Redi Binaj.

Pra deshmia e ofruar nga grupi i OE te rekomanduar per kontrate nuk eshte sipas kërkeses, prandaj edhe per kete arsye eshte dashur te eliminohet grupi i OE PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NE KOSOVE; JOOS &. KRASN1QJ - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.l., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine.

Kerkojme nga ekspertet shqyrtues qe te analizohen deshmitë e ofruara te grupit te OE te rekomanduar per kontrate ne lidhje me kërkesen per Lead auditor.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -9Pergjigje nga Eksperti profesional

Lead Auditor sipas standardit ISO 45001:2018 është një person i cili ka kualifikime dhe aftësi të nevojshme për të kryer auditime të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, të bazuar në këtë standard. ISO 45001 është një standard ndërkombëtar i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili përcakton kërkesat për një sistem efikas të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë në organizata të ndryshme.

Roli i një Lead Auditor është të kryejë auditime të jashtme ose të brendshme të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë në organizata, për të verifikuar nëse organizata po përmbush kërkesat e standardit ISO 45001 dhe ajo po operon në mënyrë të përshtatshme me politikat dhe procedurat e veta të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Një Lead Auditor i kualifikuar do të ketë njohuri të thella për standardin ISO 45001:2018, si dhe për proceset dhe metodologjitë e auditimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ata do të jenë në gjendje të planifikojnë, kryejnë dhe dokumentojnë auditimet në një mënyrë objektive dhe të drejtë. Rezultatet e auditimeve të udhëhequra nga një Lead Auditor ndihmojnë organizatat të identifikojnë zonat e rrezikut dhe të marrin hapa për të përmirësuar mjedisin e punës, duke rekomanduar ndryshime dhe korrektuese për të rritur sigurinë dhe shëndetin e punonjësve.

Shëndeti dhe Siguria në Punë, e cila është një problem global, aksidentet dhe sëmundjet profesionale janë të ndryshme në mes të bizneseve dhe madje edhe ndërmjet lokacioneve të ndryshme brenda një biznesi. Standardi ISO 45001 është një nga sistemet kryesore që duhet të aplikojnë kompanitë nga të gjithë sektorët, të vegjël apo të mëdhenj.

Qëllimi kryesor i standardit ISO 45001 është të minimizojë problemet e sigurisë në vendin e

punës, të eliminojë këto rreziqe, të sigurojë respektimin e ndërmarrjes, të tregojë përgjegjësinë e korporatës dhe të mbajë motivimin e punonjësve, asetet më të vlefshme për ndërmarrjen.

Rregullat ligjore për sigurinë në punë përbëjnë një sërë përgjegjësish ligjore për kompanitë për të menaxhuar rreziqet me të cilat ballafaqohen. Megjithatë, për të qenë në përputhje me këto rregullore ligjore dhe për të përmbushur detyrimet e tyre, ndërmarrjet duhet të vendosin politika të shëndetit dhe sigurisë në punë. Standardi ISO 45001 është i rëndësishëm këtu.

Po, një auditor i brendshëm ka potencialin të kryejë punën e Lead Auditor sipas standardit ISO 45001:2018 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Auditorët e brendshëm janë përgjegjës për të kryer auditime të brendshme në organizatën e tyre për të vlerësuar përputhjen e proceseve dhe praktikave me standardet e përcaktuara dhe me kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Redi Binaj ka gjithashtu Çertifikaten me të cilën vërtetohet se ka perfunduar me sukses trajnimin për siguri në punë.





CERTIFIKATË TRAJNIMI

Nr. i Certifikatës **AQS/T/S31772019**

Emri Mbiemri **ING. REDI BINAJ**

Datëlindja **20 - 06 - 1992**

Arsimimi **INXHIER NDERTIMI - INFRASTRUKTURE TRANSPORTI**
Dip. Nr. M-785 Datë 24-07-2015

Mori pjese ne trajnimin me teme:

"EKSPERT PER NDIHMEN E PARE DHE NDERHYRJEN NDAJ EMERGJENCEVE"

Temat e trajtuara:

Vënia në funksion e sistemit të alarmit;
- shkaqet dhe rrethanat e aksidentit; - komunikimi i tyre në mënyrë të qartë dhe të saktë, si kujdesit shëndetësor të emergjencës; Njohja e një emergjence shëndetësore; - skena e aksit gjendjes fizike dhe mendore të punëtorit të dëmtuar; - teknikat e vetë-mbrojtjes të person ndihmën e parë;
Zbatimi i masave të ndihmës së parë:
- mbajtjen e funksioneve jetësore; - njohja dhe kufijtë e ndërhyrjes së ndihmës së parë;
Njohuri të përgjithshme rreth traumave në vendin e punës:
- anatomia e skeletit; - përdredhjet, frakturat dhe komplikimet; - traumat dhe dëmtimet e kolonës vertebrale; - traumat dhe dëmtimet e krahërorit dhe abdominale;
Sëmundje të veçanta në vendin e punës:
- dëmtim nga i ftohti dhe nga nxehtësia; - dëmtim nga rryma elektrike; - dëmtim nga agjen intoksikacionet; - plagët e thella; gjakderdhje e jashtme;
Veprimi praktik:
- teknikat e kryesore të komunikimit me sistemin emergjent S.S.N.; - teknikat kryesore të ndihmës së parë; - teknikat kryesore të ndërhyrjes së shpejtë tek sindromat e ankthit; - teknikat kryesore për reanimimin kardiopulmonar; - teknikat kryesore të ndalimit të gjakut; - të ngritjes, zhvendosjes dhe transportit të të traumatizuarit; - teknikat kryesore të ndihmës ekspozimit aksidental ndaj agentëve kimikë dhe biologjikë.

Datat e trajnimit	25/09/2019	27/09/2019	Ore	24
Vendi i trajnimit	Tirane, Shqipëri			
Organizatorët e trajnimit	AQSCERT "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"			
Datat e lëshimit	27/09/2019			

Vlefshmëria e certifikatës mund të kontrollohet në www.aqscert.org/certifikata/ime/trajnim duke ndjekur udhëzimet në pasqyrën anë.



Pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar sa i përket kërkeses "Operatori Ekonomik duhet të ketë Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit të cilësive aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS .

PRETENDIMI ANKIMOR - 10

9.Operatori Ekonomik duhet të ketë një ekspert të certifikuar nga AME (adensioni për menaxhimin e emergjencave) për mbrojtje nga zjarri, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar deshmë një certifikatë të leshuar nga autoriteti shqiptar për z. Dritan Lani, e jo nga AME ashtu siç është kërkuar. Prandaj kjo certifikatë nuk është sipas kërkeses së dosjes së tenderit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -10Pergjigje nga Eksperti profesional

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ,KUVENDI - L I G J / Nr. 10 237, datë 18.2.2010 / PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 5 - pika 15. "Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë" është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 7 - Pika 2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni: a) punëmarrësi/punëmarrësit i/e ngarkuar nuk mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së tij/tyre, lidhur me mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale; b) punëmarrësit/punëmarrësve i/u jepet koha e nevojshme për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj; c) punëmarrësit/punëmarrësve i/u sigurohen nga punëdhënësi mjetet dhe trajnimi i nevojshëm për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. 3. Punëdhënësi u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke hyrë në marrëdhënie kontraktore me ta, nëse kapacitetet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për të organizuar veprimtari për mbrojtjen dhe parandalimin. 4. Punëdhënësi është i detyruar që subjekteve të kontraktuara prej tij, sipas pikës 3 të këtij neni: a) t'u japë të gjithë informacionin për faktorët e njohur ose të dyshuar, që kanë efekte për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve; b) t'u krijojë mundësi për marrjen e informacionit të parashikuar në shkronjat "a" e "b" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji.



Pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar sa i perket kërkeses "Operatori Ekonomik duhet të ketë një ekspert të certifikuar nga AME (adensioni për menaxhimin e emergjencave) për mbrojtje nga zjarri, ndersa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar deshmë një certifikatë të leshuar nga autoriteti shqiptar për z. Dritan Lani, e cila është në përputhje me DT.

PRETENDIMI ANKIMOR - 11

10. Mungon deklarata e anëtarëve të konsorciumit ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -11 Përgjigje nga Eksperti profesional

Deklarata e anëtarëve të konsorciumit që janë të përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit

dhe për ekzekutimin e kontratës është një dokument i rëndësishëm dhe i përgjegjshëm që dëshmon përkushtimin ndaj zbatimit të projektit. Kjo deklaratë është në DT dhe tregon që anëtarët e konsorciumit janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe janë të gatshëm të ndajnë përgjegjësinë për të siguruar suksesin e projektit.

Gjeni të bashkengjitur në vijim deklaratën e anetareve të konsorciumit



Konzorciumi
"PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove & "JOOS&KRASNIQI-BAZE" Sh.P.K & "Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN)

Numri i prokurimit: - 632-23-397-5-1-1
Titulli i kontratës: " Ndërtimi i rrugës X "

MARRËVESHJA PARAPRAKE PËR BASHKËPUNIM

Në mes :

"PE-VLA-KU" Sh.p.k.- Dega ne Kosove me numër unik identifikues: 810794463

Dhe

"JOOS & KRASNIQI-BAZE" Sh.P.K me numër unik identifikues : 810962309

Dhe

"Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN) me numër unik identifikues : 811129726

Data: 22.05.2023

A. FORMA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje për bashkëpunim në mes **"PE-VLA-KU " Sh.p.k – Dega ne Kosove** si partner i parë (Partner 1) i cili është edhe lider i konzorciumit dhe

"JOOS & KRASNIQI -BAZE" Sh.P.K si partner i dyte (Partner 2)

" Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN) si partner i trete (Partner 3)

PREJ TANI E TUTJE TË DY PARTNERËT JANË PAJTUAR ME SA VIJON:

B. QËLLIMI



Të tre (3) partneret do të bashkëpunojnë dhe përgatisin dokumentacionin e tenderit të lartëpërmendur me një emër të përbashkët **"PE-VLA-KU" SH.P.K- Dega në Kosovë / "JOOS&KRASNIQI-BAZE" SH.P.K / "Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN)**

C. VEPRIMTARIA DHE PËRGJEGJËSITË

Forma dhe kushtet e bashkëpunimit të partnerëve janë të përcaktuara me sa vijon:

- A. Bashkëpunimi i tri kompanive nënkupton se të tri kompanitë mbajnë përgjegjësi sipas kushteve dhe përgjegjësi të parapara.
- B. Aktiviteti dhe bashkëpunimi i të tri kompanive është i pa kufizuar për projektin në fjalë. Të gjithë hapat që ndërmirren gjatë kryerjes së punimeve duhet të jenë të koordinuara dhe do të ketë shkëmbim informacionesh nga të tre palët.
- C. Të gjitha vendimet e rëndësishme si dhe vendimet tjera duhet të ndërmerren nga të tre partneret me marrëveshje interne.

Kjo marrëveshje është e lidhur në mes të Partnerëve dhe do të zgjas deri në përfundimin e projektit të lartëpërmendur.

Marrëveshja në mes të palëve kontraktuese u arrit me datën: 22.05.2023

Nënshkruar në emër të **"PE-VLA-KU" Sh.p.k.**- Dega në Kosovë z. Arben SADRIJA



Nënshkruar në emër të **"JOOS & KRASNIQI-BAZE" SH.P.K** z.Agron KRASNIQI



Nënshkruar në emër të **"Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN)** z Ndue Komani



Numri i prokurimit: - 632-23-397-5-1-1
Titulli i kontratës: " Ndërtimi i rrugës X

DEKLARATË PËR OBLIGIM KONTRAKTUES

Unë nënshkruesi i kompanisë **"PE-VLA-KU" Sh.p.k** – Dega në Kosovë vërtetoj me këtë se obligohem për të gjitha eventualitetet të cilat mund të ndodhin në rast se partneret tane **"JOOS & KRASNIQI-BAZE" SH.P.K.**, **"Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN)** si antar i konzorciumit tërhiqen nga kontrata gjatë kryerjes së punimeve lidhur me projektin e lartpërmendur.

Po ashtu edhe **"JOOS & KRASNIQI-BAZE" SH.P.K.**, **"Roza Komani" B.I (NNSH KORBEN)** do të obligohen për të gjitha eventualitetet të cilat mund të shkaktohen nga ana e **"PE-VLA-KU" Sh.p.k** - Dega në Kosovë si lider/anëtar i konzorciumit.

Perfaqësues për Kosovë
z.Arben SADRIJA



Drejtor:
z.Agron KRASNIQI



Drejtor:
Ndue Komani



Pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar sa i përket deklaratat e anetareve të konzorciumit.

Me poshte janë të cekura edhe arsyet e eliminimit të OE tjerë e që realisht këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona.

PRETENDIMI ANKIMOR - shtese- për OE të eliminuar

A) OE Lika Trade Shpk është i përgjegjshëm dhe pajtohem me arsyen e eliminimit ku është edhe cekur si në vijim:

B) OE Victory Com&Eskavatori SHPK&Marisa SHPK është i përgjegjshëm dhe pajtohem me arsyen e eliminimit ku është edhe cekur si në vijim:

Përgjigje në PRETENDIMIN ANKIMOR - shtesë- për OE të eliminuar

Nëse ju si operator ekonomik ankues pajtoheni me arsyen e eliminimit të kompanisë "OE Lika Trade Shpk" dhe OE Victory Com&Eskavatori SHPK&Marisa SHPK, atëherë duket se keni marrë një qëndrim të qartë në lidhje me situatën nga AK.

Nëse keni marrë një përgjigje zyrtare nga autoriteti kontraktues lidhur me eliminimin e kompanisë "OE Lika Trade Shpk", dhe OE Victory Com&Eskavatori SHPK&Marisa SHPK të cilën e keni bashkëngjitur këtë përgjigje në ankesën tuaj të paraqitur, kjo ka shpjeguar se ju keni marrë një përgjigje zyrtare dhe keni marrë parasysh arsyet për eliminimin e kompanive në fjale.

Pra, në rastin e me sipërm, duke pasur parasysh se jeni pajtuar me arsyen e eliminimit të kompanisë "OE Lika Trade Shpk" dhe OE Victory Com&Eskavatori SHPK&Marisa SHPK nga autoriteti kontraktues duket se nuk ka nevojë për ndonjë veprim shtesë nga eksperti shqyrtues apo teknik në këtë drejtim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"ASFALT GROUP" SH.P.K.**



Remzi Llumnica

Donijeta Sogojeva